

VENDIM
Nr.3, datë 10.1.2007

PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË VRESHTARISË, PEMËTARISË DHE ULLIRIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet buxhetore, të miratuara në buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për vitin 2007, zëri “Transferte në buxhetet familjare”, të përdoren për nxitjen e zhvillimit të vreshtarisë, pemëtarisë dhe ullirit, si më poshtë vijon:

- Për fermerë individualë, që ngrenë vreshta ose pemëtoje të reja, me sipërfaqe jo më pak se 3 dynym;

- Për fermerë individualë, që ngrenë ullishte të reja, me sipërfaqe jo më pak se 2 dynym.

2. Masa e përfitimit të jetë, si më poshtë vijon:

- Për ngritje vreshti, 500 000 lekë/ha;

- Për ngritje pemëtojeje, 350 000 lekë/ha;

- Për ngritje ullishteje, 350 000 lekë/ha.

3. Kriteret dhe procedurat e dhënies së mbështetjes përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha